
MARITAL BARRIERS ACCORDING TO FAMILY LAW IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Shemsije Demiri

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, sh.demiri@eust.edu.mk

Driton Haruni

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, d.haruni@eust.edu.mk

Guximtar Rushani

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, g.rushani@eust.edu.mk

Rudina Kaja

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, r.sela@eust.edu.mk

Senada Lacka

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, s.lacka@eust.edu.mk

Abstract: Marital impediments are facts and circumstances determined by law, the existence of which impedes the valid marriage. They are otherwise called negative conditions and should not exist at the time of the marriage. In order to create effects they must be expressly provided in legal provisions and operate erga omnes.

Our legislation foresees these marital barriers: Lack of will, Existing marriage, Mental illness and inability to act, Gender and Minority. Viewed historically, the circle of marriage barriers has always been narrowing.

This narrowing is a consequence of the interest of the wider society for the marriage to be stable and healthy.

Its civil form has reduced to a minimum the manifestation of its will in the case of marriage as a result of physical violence or intimidation. The legislator has a duty to determine as much as possible the number of marital restrictions congruent to social reality. Avoidable marital restrictions are those for which the court may grant permission to marry, but only in cases provided by statutory provisions, such restrictions may be sex and gender-related barriers, as inevitable restrictions are the ones about which the court cannot grant permission to enter into marriage, unwillingness and existing marriage. Permanent obstacles are those that do not cease to exist even after death, but we also have temporary marriages that cease to exist over time.

Absolute restrictions prevent the marriage of any person, while real marriage restrictions prevent the marriage of only certain persons (inter partes). This classification is based on who is authorized to file a marriage cancellation lawsuit. Family law foresees that a marriage will not be valid if consent is achieved through coercion, intimidation, and adultery.

Keywords: Marital barriers in our law, unwillingness, violence, existing marriage, gender, and minorities.

PENGESAT MARTESORE SIPAS LIGJITTE SE DREJTES FAMILJARE NE REPUBLIKEN E MAQEDONISE SE VERIUT

Shemsije Demiri

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, sh.demiri@eust.edu.mk

Driton Haruni

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, d.haruni@eust.edu.mk

Guximtar Rushani

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, g.rushani@eust.edu.mk

Rudina Kaja

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, r.sela@eust.edu.mk

Senada Lacka

International University of Struga, Republic of N. Macedonia, s.lacka@eust.edu.mk

Abstrakt: Pengesat martesore (impedimentamtrimoni) janë fakte dhe rrethana të percaktuara shprehimisht në ligj, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vleshme. Ato ndryshe quhen kushte negative dhe nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Për të krijuar efekte ato duhet të jenë të parashikuara shprehimisht në dispozita ligjore dhe veprojnë erga omnes.

Legjislacioni ynë i parashihet këto pengesa martesore: Mungesa e vullnetit, Martesa ekzistuese, Semundja psikike dhe pazotesia për të vepruar, Gjinia dhe Mituria. Shikuar historikisht, rrethi i pengesave martesore ka ardhur gjithnjë

duke u ngushtuar. Ky ngushtim është rrjedhojë e interesit të shoqërisë së gjerë që martesat të jenë të qëndrueshme, stabile dhe të shëndoshë. Forma civile e saj ka reduktuar në minimum shfaqjen e vullnetit të metë në rastin e martesës, si pasojë e dhunës fizike apo kanosjes.

Ligjdhënësi ka detyrë që të përcaktojë në harmoni me realitetin shoqëror, sa më shumë të jetë e mundur numrin e pengesave martesore.

Pengesat martesore të evitueshme janë ato pengesa martesore për të cilat gjyqi mundet të jap lejen për lidhjen e martesës, por vetëm në rastet e parashikuara me dispozita ligjore, pengesat e tilla mundet të paraqiten të gjinia dhe gjinia e krushqisë, si pengesat e paevitueshme janë ato për të cilat gjykata nuk mundet të jep leje për tu lidhur martesat, mungesa e vullnetit dhe martesat egzistuese.

Pengesat e perhereshme janë ato pengesa që nuk pushojnë se egzistuarin edhe me kalimin e kohës deri në vdekje, por këto edhe martesat të perkoheshme të cilat me kalimin e kohës pushojnë se egzistuarin. Pengesat absolute pamundesojnë lidhjen e martesës me cilindo person, kurse pengesat e martesore realitive pamundesojnë lidhjen e martesës vetëm me persona të caktuar (inter partes).

Ky klasifikim merret për bazë faktin se kush është i autorizuar për paraqitjen e padisë për anulimin e martesës.

Ligji I të drejtës familjare parashahet që një martesë nuk do të jetë e vlefshme nëse pelqimi është arritur me anë të shterngimit, kercenimit dhe lajthimit.

Fjalë kyçe: Pengesat martesore në të drejtën tonë, mungesa e vullnetit, dhuna, martesat egzistuese, gjinia, dhe mituria.

1. HYRJE

Anulimi i martesës mund të bëhet në qoftë se në momentin e lidhjes nuk kanë egzistuar kushtet për lidhjen e saj, por kanë egzistuar pengesat si martesat egzistuese. Ligji për familje I Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk njihet martesat e paqena përkundër faktit se ky institut në legjislacionin e mëhershëm ishte i rregulluar me dispozita ligjore. Ligji për familjen në nenin 35 dhe 36 parashihet që martesat mund të anulohet nëse kërkesat formale të këtij ligji nuk janë plotësuar. Është e qartë se ligji për familjen ngatëron institucionin e martesës së paqenë me anulimin e martesës. Martesat e paqena quhen martesat e lidhura pa plotësimin e kushteve thelbësore, ndërsa martesat e anuluarat janë ato martesat të lidhura me gjithë egzistimin e pengesave martesore, qofshin ato absolute apo relative.

Martesa e paqenë nuk lindë asnjë pasojë martesore dhe bashkëshortët në një martesë të tillë konsiderohen se nuk kanë qenë kur bashkëshortët. Për fëmijët nga martesat e paqenë vlejnë po ato dispozita ligjore të cilat vlejnë edhe për fëmijët nga martesat. Procedura për vërtetimin e martesës së paqenë inicohet me padi.

2. PENGESAT MARTESORE NË TË DREJTËN TONË

Legjislacioni ynë parashihet këto pengesa martesore:

- mungesa e vullnetit,
- martesa egzistuese,
- sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar,
- gjinia, dhe
- mituria.

Konsiderohen pengesa ligjore për lidhjen e martesës, ekzistenca e rrethanave të mëposhtme, të cilat pengojnë lidhjen e martesës. Martesa e lidhur në këto kushte, konsiderohet e pavlefshme. Pengesat ligjore për lidhjen e martesës janë:

Ekzistenca e një martesë të mëparshme, e cila nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur. Lidhja gjinore, sipas të cilës nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit (ati me të bijën, nëna me djalë, gjyshi me mbesën, gjyshja me nipin), vëllai dhe motra, ungujt dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave. Gjykata, për shkakë me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave.

Lidhja e krushqisë, sipas të cilës nuk mund të lidhin martesë midis tyre vjehri dhe nusja, vjehrra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtira, njerka dhe thjeshtiri, pavarësisht se martesat që ka krijuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme, ka pushuar ose është zgjidhur.

Ekzistenca e një sëmundje të rëndë psikike ose zhvillim mendor të metë, që e bën personin të paafatë të kuptojë qëllimin e martesës.

Ekzistenca e një marrëdhënie kujdestarie midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.

Lidhja familjare që bazohet në marrëdhënien e birësimit, ku dallohet martesë midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit, midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit.

Në teorinë juridike pengesat martesore klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, si:

- a). Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme,
- b). Pengesat martesore të përherëshme dhe të përkohëshme, dhe
- c). Pengesat martesore absolute dhe relative

a). Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme

Ky klasifikim merr si kriter bazë mundësinë e evitimit të mungesës konkrete martesore. Të evitueshme janë ato pengesa martesore për të cilat gjyqi mundë të japë lejen për lidhjen e martesës, por vetëm në raste të parashikuara me dispozita ligjore. Pengesat e tilla në të drejtën tonë janë mituria dhe gjinia e krushqisë, nga se rastet e justifikueshme gjykata mundë të lejojë lidhjen e martesës me gjithë egzistimin e këtyre pengesavemartesorë.

Pengesa martesore të paevitueshme janë pengesat për të cilat gjykata nuk mundë të jap leje (dispenzacion)për të lidh martesë. Pengesat e paevitueshme janë: mungesa e vullnetit dhe martesë egzistuese, smundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar si dhe gjinia e gjakut .

b). Pengesat martesore të përherëshme dhe të përkohëshme

Pengesat martesore të përherëshme janë ato pengesa që nuk pushojnë së egzistuari edhe me kalimin e kohës, deri në vdekje. E till është gjinia e gjakut.

Pengesa martesore të përkohëshme janë pengesat të cilat me kalimin e kohës mundë të pushojnë së egzistuari. Të tilla janë : mungesa e vullnetit , martesë egzistuese, smundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar dhe mituria.

c). Pengesat martesore absolute dhe relative

Pengesa martesore absolute pamundësojnë lidhjen e martesës me cilindo person. Të tilla janë : sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, mituria deri në moshën 16 vjecare dhe egzistimi I martesës. Pengesat martesore absolute veprojnë mbi të gjithë personat(erga omnes).

Pengesat martesore realitive pamundësojnë lidhjen enjë martesë vetëm me personat e caktuar(gjini krushqie). Pengesat e tilla veprojnë vetëm mbi persona të caktuar(inter partes). Ky klasifikim merr për bazë faktin se kush është I autorizuar për paraqitjen e padisë për anulimin e martesës.

Me pengesa absolute shkelen interes e përgjithëshme shoqërore, andaj është I gjerë rrethi I personave të cilët kanë të drejtë të parashtrojnë padi- secili nga bashkëshortët, prokurori public dhe të gjithë personat që kanë interes drejtëpërdrejtë të ligjshëm që martesë të anulohet. Nga ana tjetër, me pengesa realitive shkelen vetëm interes personale të personave dhe vetëm bashkëshortët mund të paraqesin padinë për anulimin e martesës.

3. MUNGESA E VULLNETIT SI PENGESË MARTESORE SIPAS LEGJISLACIONIT POZITIV TE RMV-SE

Vullneti I deklaruar lirisht është prezumim I vetëm për lidhjen e një martesë të vlefshme.

Neni 19 I Ligjit të familjes në RMV parasheh që një martesë nuk është e vlefshme nëse pëlqimi është aritur me anë të shtërngimit, kërcënimit ose lajthimit .

Dhuna që ushtrohet për lidhjen e martesës, në kundërshtim me vullnetin e brendshëm , të vërtet të bashkëshortit mundë të jetë e natyrës psikologjike dhe fizike, kurse me kanosje kuptojmë vetëm ushtrimin e dhunës psikologjike dhe jo dhunës fizike.

Lajthimi – egziston kur njëri nga bashkëshortët ka pasur mendim të gabueshëm mbi rrethanat, faktet dhe mbi cilësitë thelbësore të bashkëshortit tjetër në momentin e lidhjes së martesës, egzistenca e të cilave jetesën e përbashkët e bëjnë të padurueshme.

Lajthimi mundë të jetë : lajthimi për personin fizik , për personin qytetar dhe për cilësitë thelbësore.

Lajthimi për personin fizik egziston kur njëri nga bashkëshortët, duke menduar se po lidh martesë me personin a, në të vërtet ai gabimisht lidh martesë me personin b, këto raste të lajthimit janë të ralla, por ende të mundëshme posacërisht kur është fjala për lidhje të martesës me anë të përfaqësuesit me prokurë sidomos në vendet ku kjo mundësi parashihet me legjislacione .

Lajthim me personin qytetar – egziston atëher kur një person lidh martesë me një person tjetër fizik, me të cilin ska menduar dhe ska pasur qëllim që të marrohet.

Personi qytetar përbëhet nga katër elemente themelore:1).Emri personal(emri dhe mbiemri), 2).Shënimi I ditës muajit dhe vitit të lindjes, 3). Shtetësia dhe 4).Vendëbanimi.

Paraqitja e rrejshme bëhet duke falsifikuar dokumentet e identifikimit, pasaportën apo aktlindjen e vetë, nga njëra anë , kurse nga ana tjetër duke prezentuar me dokumente të huaja , të vjedhura apo të keqpërdorura, vecanërisht të personaliteteve të tjera të shquara që kanë krijuar me shkencë , artë, film, sport, apo ndonjë fushë tjetër të rëndësishme shoqërore.

Lajthimi për cilësitë thelbësore të personit-ekziston nëse njëri prej bashkëshortëve është në lajthitje(ka mendim të gabuar) mbi disa cilësi të personit tjetër, të cilat po të ishin të njohura në castin e lidhjes së martesës, gjithsesi se do ndikonin në të dhe nuk do ta lidhte martesën.

Gjinia e gjakut është pengese martesore në shkallë dhe në vije të percaktuar në dispozitat ligjore. Nuk mund të lidhet martesë midis personave në gjini gjaku në vije të drejta pa kufizim, ndërsa në vije të terthorte deri në shkallë të katert.

Rrethana gjini si pengese martesore absolute martesore paraqitet krejtësisht për shkakë oportuniteti, si morali, psikologjike ashtu edhe për arsye biologjike. Femijet e një bashkimi të tillë rrezikohen të preken nga të meta të medha fizike dhe psikologjike.

Gjinia si lidhje gjaku krijohet midis personave që rrjedhin nga njëri tjetri, ose nga një të paralindur të perbashket.

Gjinia e krushqisë në kuptimin juridik është lidhje që krijohet midis njerit bashkeshort dhe personave gjini të bashkeshortit ligjor. Baze për krijimin e kësaj gjinie ishte martesë.

Gjinia e krushqisë e krijuar njëhere, nuk mund të pushojë edhe nëse ka pushuar martesë, pra është e përhershme.

Nuk mund të lidhin martesë personat në krushqi, pa marrë parasysh faktin nëse ka pushuar martesë lidhja e të cilës ka krijuar këtë marrëdhënie. Kto dispozita janë të karakterit urdherues. Kjo ndalesë ekziston edhe kur martesë shpallet e pavlevshme, ka pushuar ose është zgjidhur.

Kjo pengese martesore absolute është e evitueshme sepse gjykata autorizohet të lejojë lidhjen e martesës midis personave gjini krushqie për shkakë të arsyeshme.

Gjinia e birsimit është pengese për lidhjen e martesës së vleshme. Nuk mbeshet në ndonjë lidhje gjaku. Birsimi mund të jetë I plote dhe jo I plote. LFM në vetëm birsimin e plote, sikurse gjinine e gjakut.

Krejt çfarë thuhet për gjinine e gjakut si pengese martesore vlen edhe për adoptimin e plote.

MITURIA është pengese absolute martesore, sepse vetëm personi madhor mund të lidhë martesë të vlefshme juridikisht. Në këtë mënyrë ligji mbron femijet që nuk janë në gjendje të kryejnë të drejtat dhe detyrimet martesore, duke mos u dhënë leje të lidhin martesë, për shkakë të papjekurisë fizike dhe psikike të tyre.

4. PERFUNDIMI

Pengesat martesore janë në funksion të forcimit të martesës si bashkësi jetësore e një buri dhe një gruaje. Ato ndjekin martesën si dëshmitarë besnik të sajënë shekuj dhe pamundësojnë martesën në rrethana të caktuara dhe të njerëzve të caktuar.

Shikuar historikisht rrethi I pengesave martesore ka ardhur gjithnjë duke u ngushtuar. Ky ngushtim është rrjedhojë e interesimit të shoqërisë së gjerë që martesë të jetë e qëndrueshme, stabile dhe e shëndoshë.

Forma e lidhjes së martesës ka reduktuar në minimum shfaqjen e vullnetit të metë me rastin e martesës, si pasojë e dhunës fizike apo kanosjes.

Ky reduktim nuk duhet të përfshijë edhe pengesat e karakterit endogjen (biologjik) ngase fëmijët lindin me të meta dhe një gjë e tillë shpie drejt degjenerimit të popullsisë.

Ligjdhënësi ka detyrë të përcaktojë në harmoni realitetin shoqëror, sa më shumë të jetë e mundur numrin e pengesave martesore . Kufizimi I tepërt I numrit të pengesave martesore nuk përputhet me botëkuptimet e popullit , si dhe me ligjet biologjike , kurse zmadhimi I tyre mundë të çojë drejtë rritjes numerike të bashkësisë jashtëmartesore që nuk krijon efekte juridike të përcaktuara me norma ligjore.

Mosrespektimi I pengesave martesore shkakton pavlefshmërinë e martesës, qoftë ajo absolute apo relative si dhe përgjegjësinë penale të bashkëshortëve dhe të personelit zyrtar I cili ka mundësuar lidhjen e një martesë të tillë, pra si sanksionin familjar-anulimi I martesës , dhe sanksionin penalo-juridik.

Mosrespektimi I pengesave martesore shkakton cenimin e interesave të përgjithëshme shoqërore dhe të drejtën për ngritjen e ankesës e kanë : prokurori publik, bashkëshortët dhe personat të cilët kanë një interes juridik të drejtëpërdrejtë që martesë të anulohet, kurse kur është fjala për ndalesa të drejtën e ngritjes së padisë e kanë vetëm bashkëshortët.

Për pengesa absolute martesore e drejta e ngritjes së padisë nuk parashkruhet ndërsa për ndalesa e drejta e padisë parashkruhet në kushtet e përcaktuara me ligj.

LITERATURA

Aliu A. & Gashi H. (2015) “E drejta familjare” Ribotim, Prishtinë

Alincic M., & Mihanovic B.A.,(1980), “Porodico pravo”(Zakonodavstvo SR Hrvatska)Zagreb.

Komar J.M., Konac R., & Ponjavic Z., (1999), “Porodico pravo”, Izdavocko preduzece”Homoc”d.o.o.Beograd

Laurasi, Am, (2016), “Marrëdhëniet familjare”, Tiranë

Loguette, S., Arnason Th. (n.d.) .: “Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut” publikuar në Holland

Mladenovic, M., (1974), *Razvod braka I uzroci za razvod braka*” Rad, Beograd

- Podvorica, H., (2015), “*E drejta Familjare*” Prishtine
- Podvorica, H., (2014), “*Pengesat dhe ndalesat martesore*”, E drejta “E drejta” nr.1/5, Prishtinë
- Trpinovska, G.L., (1997), “*Semejno Pravo*”, NIP Studentski zbor , Skopje
- Zaqe, V., (1999), *Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar*, Tiranë.
- Kodi I familjes I Republikës së Shqipërisë*, nr.90/62. 08.05.2003
- Kodi I përkohshëm I Kosovës* (gazeta zyrtare e Kosovës, nr.25/2003).
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, 1950
- Ligji mbi familjen I Republikës së Maqedonisë së Veriut , nr.80/1992.
- Zakon za semejstvo , so objacnuvana I sudska praktika I so predmeten registar, Skopje, 1993.
- Ligjit mbi Familjen* (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 115/14).
- Sluzben Vesnik na Republika Makedonija , br.138 od 17.09.2014 godina